



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE
MINISTRY OF FINANCE

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

SKK 7

Kontabiliteti për grantet qeveritare dhe shpalosja e ndihmës qeveritare

Qëllimi

Qëllimi i këtij standardi është që ta përshkruajë paraqitjen, trajtimin dhe shpalosjen e donacioneve dhe ndihmës qeveritare në kontabilitet. Meqë pranimi i 'granteve' dhe ndihmës qeveritare mund të ketë një ndikim të madh, megjithëse të përkohshëm, në rezultatet e raportuara financiare të afarizmit të ndërmarrjes, është me rëndësi që çdo 'grant' dhe ndihmë e tillë të trajtohet dhe shpaloset në mënyrë të duhur.

Fushëveprimi

1. Ky standard duhet të zbatohet në kontabilitet për shpallje të granteve qeveritare dhe për shpalosje të formave të tjera të ndihmës qeveritare.
2. Ky standard nuk ka të bëjë me:
 - (a) pjesëmarrjen e qeverisë në pronësinë e ndërmarrjes

- (b) ndihmën shetërore të siguruar për ndërmarrjen që është në formë të përfitimeve që i përkasin, përcaktohen ose kufizohen nga detyrimet tatimore në të hyra. Shembujt e këtyre i përfshijnë tatimet kreditore dhe zvogëlimin e shkallës tatimore.
- (c) ndihma qeveritare të siguruara në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nëpërmjet aksioneve që ndikojnë në përgjithësi në ekonomi, siç është infrastruktura e zhvillimit

Përkufizimet

3. Termat vijues në këtë standard janë përdorur me këto kuptime specifike:

Qeveri konsiderohet qeveria, agjencitë qeveritare dhe organizmat e ngjashëm, qofshin lokalë, kombëtarë ose ndërkombëtarë.

Ndihma qeveritare është veprim i qeverisë i projektuar për të siguruar përfitim ekonomik të një ndërmarrjeje ose ndërmarrjeve që kualifikohen sipas kriterëve të caktuar.

Grantet qeveritare janë ndihmat e qeverisë në formë të transferit të burimeve në një ndërmarrje si përgjigje për pajtimin e saj në të kaluarën apo në të ardhmen me kushtet e caktuara që ndërlidhen me aktivitetet afariste të ndërmarrjes. Ato nuk i përfshijnë llojet e ndihmave qeveritare që nuk mund të kenë vlerë të arsyeshme të vendosur në to dhe transaksionet me qeveri që nuk mund të dallohen prej aktiviteteve të rëndomta tregtare të ndërmarrjes.

Grantet lidhur me pasurinë janë grantet qeveritare ku kusht primar që një ndërmarrje të kualifikohet për to, është se duhet të blejë, ndërtojë ose të marrë pasuri afatgjatë. Mund të ketë, po ashtu, edhe kushte të tjera të caktuara që kufizojnë llojin ose lokacionin e pasurisë.

Grantet lidhur me të ardhurat janë grantet e tjera qeveritare karshi atyre që lidhen me pasuri.

Kreditë e pakthyeshme janë kreditë kur kredithënësi heq dorë nga kthimi i kredisë në rrethana të caktuara.

Vlera fer është shuma për cilën një pasuri mund të këmbehet ndërmjet një blerësi të vetëdijshëm, të vullnetshëm dhe një shitësi të vetëdijshëm, të vullnetshëm në një transaksion “duarlibër”.

Transaksioni “duarlibër” është transaksioni midis palëve që nuk janë të lidhura mes vete dhe secili vepron sipas interesit të vet personal.

4. Ndhimja qeveritare merr forma të ndryshme varësisht nga natyra e ndihmës së dhënë dhe në kushtet që zakonisht i bashkangjiten asaj. Qëllimi i ndihmës mund të jetë përkrahje ndërmarrjes që të nisët në drejtim të veprimit që normalisht nuk do të ndërmerret nëse ndihma nuk sigurohet.
5. Pranimi i ndihmës qeveritare nga një ndërmarrje mund të jetë e rëndësishme për përgatitjen e pasqyrave financiare për dy arsye. Së pari, nëse mjetet janë transferuar, duhet të gjendet një metodë adekuate e kontabilitetit për këtë transfer.

Së dyti, është e dëshirueshme të jepet një indikacion për shkallën e përfitimit të ndërmarrjes nga ndihma e tillë gjatë periudhës raportuese. Kjo e lehtëson krahasimin e pasqyrave financiare të një ndërmarrjeje me periudhat paraprake dhe me ato të ndërmarrjeve të tjera.
6. Grantet qeveritare ndonjëherë quhen me emra të tjerë siç është: subvencioni.

Grantet qeveritare

7. Grantet qeveritare, përfshirë grantet jomonetare në vlerë fer, nuk duhet të njihen, derisa të ekzistojë bindja e arsyeshme se:
 - (a) ndërmarrja do t'i bindet kushteve shtesë; dhe
 - (b) grantet do të pranohen.
8. Granti qeveritarë nuk njihet, derisa të ekzistojë një bindje e arsyeshme se ndërmarrja do t'i bindet kushteve shtesë të saj dhe që grantet do të pranohen. Pranimi i grantit nuk nënkupto vetvetiu sigurim të evidencës vendimtare se kushtet shtesë për grantin kanë qenë të plotësuar ose do të plotësohen.
9. Mënyra se si është marrë granti nuk ndikon në metodën e pranuar të kontabilitetit sa i përket grantit. Pra, granti përlllogaritet në mënyrë të njëjtë qoftë kur pranohet në të gatshme ose si zvogëlim i detyrimit ndaj qeverisë.
10. Kredia e pakthyeshme nga qeveria trajtohet si grant qeveritare, kur ekziston siguri e arsyeshme se ndërmarrja do t'i plotësojë kushtet e kredisë së pakthyeshme.
11. Granti qeveritarë duhet të njihet si e hyrë gjatë periudhave të nevojshme për t'i barazuar ato me shpenzimet përkatëse që synohet të

kompenzohen mbi baza sistematike. Ato nuk duhet ta kreditojnë drejtpërsëdrejti interesin e aksionarëve.

12. Është çështje themelore që grantet qeveritare të njihen si e ardhur në bazë sistematike dhe racionale gjatë periudhave të nevojshme për barazim të tyre me shpenzimet përkatëse. Njohja e të ardhurës së granteve qeveritare në bazë pranimi nuk është në pajtim me kontabilitetin aktual të supozuar.
13. Në shumicën e rasteve periudhat, gjatë të cilave ndërmarrja i njeh kostot ose shpenzimet që kanë të bëjnë me grantet qeveritare, janë pothuaj të konstatuara dhe kështu grantet për njohjen e shpenzimeve specifike, njihen si të ardhura në periudhën e njejtë si edhe shpenzimet e rëndësishme. Ngjashëm, grantet lidhur me pasurinë e amortizueshme zakonisht njihen si të ardhura gjatë periudhave dhe në raport me të cilin amortizimi në këtë pasuri është ngarkuar.
14. Grantet lidhur me pasurinë e joamortizueshme, po ashtu, mund të kërkojnë plotësim të detyrimeve të caktuara dhe ato do të njihen si e ardhur gjatë periudhave që bartin shpenzimet për plotësimin e detyrimeve. Për shembull, granti i tokës mund të jetë i kushtëzuar pas ngritjes së ndërtesës në vendpunim dhe mund të jetë i përshtatshëm që të njihet si e ardhur gjatë ekzistimit të ndërtesës.
15. Granti qeveritarë që shndërrohet në kërkesë si kompenzim për shpenzimet ose humbjet tanimë të krijuara ose me qëllim të dhënies së përkrahjes së menjëhershme financiare për ndërmarrjen pa shpenzime të lidhura në të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën shndërrohet në kërkesë.
16. Në rrethana të caktuara, granti qeveritarë mund të jepet më tepër me qëllim të dhënies së përkrahjes së menjëhershme financiare një ndërmarrjeje se sa një nxitje për të marrë përsipër shpenzimet specifike. Grantet e tilla mund të kufizohen për një ndërmarrje individuale dhe mund të pamundësohen për një kategori të tërë të përfituesve. Këto rrethana mund ta sigurojnë njohjen e grantit si e ardhur në periudhën, kur ndërmarrja kualifikohet për ta pranuar atë si një zë të jashtëzakonshëm, nëse është e përshtatshme (shiko SKK 5 “Fitimi neto ose humbja për periudhë, zërat e jashtëzakonshëm, ndryshimet në vlerësimet e kontabilitetit, ndryshimet në politikat kontabël dhe gabimet fundamentale”), me shpалosjen që siguron se efekti i tij kuptohet qartë.
17. Granti qeveritarë mund të shndërrohet në kërkesë nga një ndërmarrje si kompenzim për shpenzimet ose humbjet e krijuara në periudhën paraprake të kontabilitetit. Granti i tillë qeveritarë njihet si e ardhur në

periudhën, kur ajo shndërrohet në kërkesë, si një zë i jashtëzakonshëm - në rast nevojë - me shpалosjen që siguron se efekti i tij kuptohet qartë.

Grantet jomonetare qeveritare

18. Granti qeveritarë mund ta marrë formën e transferit të pasurisë jomonetare, siç është toka ose burimet tjera, për përdorim të ndërmarrjes. Në këto rrethana është e zakonshme që të vlerësohet vlera fer e pasurisë jomonetare dhe të llogariten të dyjat si grantin qeveritarë edhe pasurinë në vlerën fer të saj.

Paraqitja e granteve lidhur me pasurinë

19. Granti qeveritarë lidhur me pasurinë, përfshirë grantin jomonetar në vlerë fer, duhet të paraqitet në pasqyrën e bilancit, duke e zbritur grantin e arritur në vlerën bartëse të pasurisë.
20. Granti njihet si e ardhur gjatë ekzistimit amortizues të pasurisë me mënyrën e ngarkesës së zbritur të amortizimit.
21. Blerja e pasurisë dhe pranimi i grantit të lidhur mund të shkaktojë lëvizje të mëdha në rrjedhën e parasë së ndërmarrjes. Për këtë arsye dhe në mënyrë që ta tregojë investimin bruto në pasuri, lëvizjet e tilla shpesh shpalosen si zëra të ndarë në raportin e rrjedhës së parasë pavarësisht se a është apo nuk është zbritur nga pasuria përkatëse me qëllim të paraqitjes në pasqyrën e bilancit.

Paraqitja e granteve lidhur me të ardhurën

22. Grantet lidhur me të ardhurën paraqiten si kredi në pasqyrën e të ardhurave, ose ndaras ose në pozicionin e përgjithshëm si “të ardhurat e tjera”.
23. Është e papërshtatshme të maten të ardhurat dhe shpenzimet lidhur me grantet. Ndarja e të ardhurave të grantit nga shpenzimet e lehtëson krahasimin me shpenzimet e tjera që nuk ndikohen nga granti.

Kthimi i granteve qeveritare

24. Granti qeveritarë që bëhet i pagueshëm duhet të llogaritet si ndryshim në vlerësimin kontabël (shih SKK 5 “Neto fitimi ose humbja për periudhë, zërat e jashtëzakonshëm, ndërrimet në vlerësimet kontabël, ndërrimet në politikat kontabël dhe gabimet fundamentale”). Kthimi i grantit lidhur me të ardhurën duhet të zbatohet së pari kundër ndonjë kredie përkatëse të shtyrë e të paamortizuar. Deri në nivelin që pagesa e tejkalon ndonjë kredi të tillë të shtyrë, ose ku nuk ekziston kredia e shtyrë, pagesa duhet të

njihet menjëherë si shpenzim. Kthimi i grantit lidhur me një pasuri duhet të regjistrohet duke e rritur vlerën bartëse të pasurisë me shumën e pagueshme. Amortizimi i mbledhur shtesë që ka qenë njohur deri më tani si shpenzim në mungesë të grantit duhet të njihet menjëherë si shpenzim.

Ndihma qeveritare

25. Të përjashtuara nga përkufizimi i grantit qeveritar, ekzistojnë forma të caktuara të ndihmës qeveritare që nuk mund të kenë vlerë të arsyeshme të vendosur në to dhe transaksione me qeveri që nuk mund të dallohen nga transaksionet normale tregtuese të ndërmarrjes.
26. Shembujt e ndihmës që nuk kanë vlerë të arsyeshme të vendosur në to janë këshillat e lira teknike dhe garancionet. Një shembull i ndihmës që nuk mund të dallohet nga transaksionet normale tregtuese të ndërmarrjes është politika e prokurimit të qeverisë që është përgjegjëse për pjesën shitëse të ndërmarrjes. Përfitimi ekziston, por nuk mund të ndahet në mënyrë të arsyeshme nga aktivitetet e tjera tregtuese.
27. Nëse përfitimet nga llojet e ndihmës qeveritare të përmendura janë të mëdha, shpalosja e llojit, niveli dhe kohëzgjatja e ndihmës janë të nevojshme, në mënyrë që raportet financiare të mos jenë çorientuese.
28. Kreditë me normë të interesit zero ose të ulët janë formë e ndihmës qeveritare, por përfitimi në krahasim me normat normale të interesit të tregut nuk llogaritet.
29. Ky standard nuk i përfshin ndihmat qeveritare, siç janë përmirësimet në infrastrukturë dhe pajisje që janë të gatshme për përfitim të bashkësisë lokale në tërësi.

Shpalosja

30. Çështjet vijuese duhet të shpalosen:
 - (a) politika e kontabilitetit e përvetësuar për grantet qeveritare, përfshirë përvetësimin e metodave të paraqitjes në raportet financiare.
 - (b) lloji dhe niveli i granteve qeveritare të njohura në raportet financiare dhe e dhëna mbi format e tjera të ndihmës qeveritare, nga të cilat ndërmarrja ka përfitim drejtpërdrejt.
 - (c) kushtet e paplotësuara dhe pasiguritë e tjera e njohura në raportet financiare që i shtohen ndihmës qeveritare.

Dispozitat kalimtare

31. Ndërmarrja që e përvetëson standardin për herë të parë duhet t'i aplikojë dispozitat e kontabilitetit të standardit vetëm për grantet ose pjesët e granteve që shndërrohen në kërkesa ose të pagueshme pas hyrjes në fuqi të këtij standardi.

Hyrja në fuqi

32. Ky standard i kontabilitetit në Kosovë hyn në funksion për raportet financiare prej 1 janarit 2002 e tutje. Përkrahet aplikimi i mëhershëm.